



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi – Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr.98  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302  
Prishtinë, më 9 korrik 2024, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Mirsad Shkreta, Burim Meta, Bekim Haxhiu dhe Shemsedin Dreshaj, anëtarë.

**Munguan:** Haxhi Avdyli, Floretë Zejnullahu dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

**Pjesëmarrësi i ftuar:** Arben Vitia, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

**Stafi mbështetës :** Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Virtyte Krasniqi, Kadrije Sherifi dhe Amir Keka, MSH; Violeta Salihu-Emini nga KSHMS-ja.

**Mbledhjen e kryesoi** Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 30.5.2024 dhe 10.6.2024;**
- 3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Arben Vitia**  
Temat: Diskutim për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale;
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 30.5.2024 dhe 10.6.2024**

*Procesverbalet e mbledhjeve mbajtur të datës: 30.5.2024 dhe 10.6.2024, u miratuan pa vërejtje.*

### **3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Arben Vitia**

Temat: Diskutim për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale

**Fatmire Kollçaku**, fillimisht e përgëzoi ministrin e Shëndetësisë z. Arben Vitia, për punën që është duke e bërë në investimet kapitale në renovimin e tërësishëm të disa klinikave brenda Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Ne, si Komision, javën e kaluar ishim për vizitë në njërin prej klinikave të rinovuar, në Klinikën e Onkologjisë dhe aty ishte kryer një punën shumë e mirë, duke ofruar kushtet shumë më të mira për pacientët, që trajtohen aty, po ashtu edhe për personelin mjekësor, që ofron shërbimet e terapisë mjekësore. Tema për të cilën do të diskutojmë sot, është për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale. Lidhur me këtë çështje, është ftuar ministri i Shëndetësisë, z. Arben Vitia, të cilit ia jap fjalën.

**Arben Vitia, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë**, fillimisht e prezantoi Ligjin për çmimin e produkteve medicinale, që e rregullon çështjen për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, si në vijon: Korniza ligjore për çmimin tavan të barnave dhe raport kronologjik i punës së komisionit respektiv. Korniza ligjore dhe mekanizmat përkatës për zbatimin e ligjit. Siç jeni në dijeni, në gusht të vitit 2023, ka hyrë në fuqi Ligji nr. 08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, i cili ka për qëllim të përcaktojë çmimet e produkteve medicinale për qarkulluesit e licencuar farmaceutikë me shumicë dhe pakicë në Republikën në Kosovës. Për zbatimin e këtij ligji, ministria ka hartuar edhe planin e veprimit, me aktivitetet konkrete dhe veprimet që duhet ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë për një zbatim efikas të kësaj fushe. Ky ligj zbatohet për qarkulluesit me pakicë dhe shumicë të produkteve medicinale, përfaqësuesi i mbajtësit të autorizimit për marketing, mbajtësi i autorizimit për marketing dhe institucionet publike. Parimet e këtij ligji janë: sigurimin me kosto të përballeshme të produkteve medicinale të nevojshme dhe efikase për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Çmimet e produkteve medicinale të regjistruara për qarkullim sipas akteve ligjore në fuqi, rregullohen sipas metodologjisë dhe në përputhje me qëllimet dhe dispozitat e këtij ligji. Ligji ka përcaktuar dy mekanizma kryesorë, që kanë për qëllim zbatimin e këtij ligji, që janë dy komisione, të cilat themelohen me vendim të ministrit: struktura, mandati, kompetencat e dy komisioneve janë të përcaktuara me nenet e veçanta të këtij ligji. Komisioni për Çmime të Produkteve Medicinale përcakton çmimet e produkteve medicinale, bazuar në metodologjinë e çmimeve referente të jashtme; Komisioni i Ankesave është organ epor, që shqyrton ankesat, kundër publikimit të listës zyrtare për çmimin e produkteve medicinale; ministri i Shëndetësisë, në dhjetor të vitit 2023, ka themeluar komisionet respektive për zbatimin e këtij ligji. Sfidë e fillimit të punës së këtij Komisioni ka qenë përbërja e Komisionit, ku fillimisht dy anëtarë kanë dhënë dorëheqje në respektimin e nenit 9 të paragrafit 13, që përcakton se anëtar i/e Komisionit nuk mund të jetë zyrtari/ja i/e cili/a në tri (3) vitet e fundit ka punuar apo ka zotëruar kompani farmaceutike. Pas plotësim-ndryshimit të vendimit edhe me dy anëtarë tjerë të këtij Komisioni, ka pasur dyshime për konflikt të mundshëm të interesit, ku janë ndërmarrë veprimet nga farmacistët respektivë, me marrjen e opinionit ligjor brenda ministrisë dhe deri tek Agjencia për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e cila i ka njoftuar zyrtarët që konflikti i interesit në këtë Komision, mund të jetë i mundshëm. Pra, deri në mars të vitit 2024, Komisioni për Komisioni për Çmime të Produkteve Medicinale nuk ka mundur të jetë funksional dhe me

përbërje të plotë, për fillimin e punës. Neni 5 i këtij ligji rregullon metodologjinë e përcaktimit të çmimeve si në vijim: Llojet e çmimit të produkteve medicinale, që përcaktohen nga Komisioni, janë: çmimi me shumicë; çmimi me shumicë për produkte gjenerike; çmimi me pakicë; çmimi me pakicë për produkte gjenerike. Çmimet e produkteve medicinale publikohen në listën zyrtare të çmimit të produkteve medicinale nga ministria. Kjo listë hartohet nga Komisioni dhe miratohet nga ministri, e cila publikohet dhe përditësohet në mënyrë periodike por jo më vonë se data pesë (5) e çdo muaji. Të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private janë të obliguara të kenë të paraqitur në formë fizike dhe elektronike listën e çmimeve, nga lista zyrtare e çmimeve, të produkteve medicinale që i disponojnë. Neni 6, ka përcaktuar që Komisioni për Çmime të Produkteve Medicinale, përcakton çmimet e produkteve medicinale, bazuar në metodologjinë e çmimeve referente të jashtme dhe përcaktimi i çmimeve të produkteve medicinale bëhet për secilin produkt individual. Sipas neni 7 të këtij ligji është përcaktuar procedura e deklarimit të çmimit si në vijim: deklarimi i çmimit bëhet nga ana e bartësit të autorizimit për marketing në Kosovë apo përfaqësuesit me autorizim të bartësit të autorizim marketingut. Bartësi i autorizimit për marketing në Kosovë apo përfaqësuesi me autorizim të bartësit të autorizim marketingut, dorëzon deklarimin e çmimit me shumicë për të gjitha produktet medicinale që posedojnë autorizim për marketing që regjistrohen sipas akteve ligjore përkatëse pranë AKPPM-së. Bartësi i autorizimit për marketing në Kosovë, apo përfaqësuesit e autorizuar të tyre, obligohen të bëjnë deklarimin e rregullt vjetor për çmime të produkteve medicinale, përveç kur aplikojnë për autorizim për marketing për herë të parë, ku njëkohësisht me aplikimin për autorizim për marketing duhet të bëjnë edhe deklarimin e çmimit sipas afateve të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara nga ministri. Neni 8, metodologjia e përcaktimit të çmimit: bazë e përcaktimit të çmimit të produkteve medicinale është metodologjia e çmimeve referente të jashtme. Burimet e të dhënave në lidhje me çmimin me shumicë të produkteve medicinale janë publikimet e raporteve zyrtare më të reja të kohës, portali zyrtar në rrjet i institucioneve përgjegjëse zyrtare të këtyre shteteve referente: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Kroaci dhe vendi i origjinës. Në mungesë të çmimit të produktit nga shtetet e specifikuar nga paragrafi 2 i këtij neni, burim i të dhënave në lidhje me çmimin me shumicë të produkteve medicinale janë publikimet e raporteve zyrtare më të reja të kohës, portali zyrtar në rrjet i institucioneve përgjegjëse zyrtare të këtyre shteteve referente: Slloveni, Estoni, Bullgari dhe vendi i origjinës. Në rast të pamundësisë për të siguruar informata përmes burimit të informacionit të përcaktuar në këtë ligj, atëherë informatat do të merren me rrugë zyrtare nga shtetet e specifikuar në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni. Në rast se çmimi i deklaruar nga ana e bartësit të autorizim-marketingut, apo përfaqësuesi i mbajtësit të autorizimit të marketingut për territorin e Republikës së Kosovës, është i barabartë ose më i ulët se çmimi i kalkuluar nga Komisioni, atëherë çmimi i deklaruar bëhet çmim i detyrueshëm për shitje në Kosovë.

**Bekim Haxhiu**, tha se shqetësimet e ngritura nga deputetët dhe të Komisionit, janë lidhur me publikimin e listës zyrtare të produkteve medicinale, për të cilën çështje ju kemi ftuar sot në Komision. Pasi publikimit të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, ka pasur produkte me çmime shumëfish më të larta. Në disa prej analizave që i kemi bërë të asaj liste, del që ka rritje shumëfish të çmimeve nga 100% e deri në 300% më të larta. Kjo nuk ka logjikë. Kjo ngritje e çmimeve kaq e lartë mund të ketë ndodhur edhe si pasojë e gabimeve teknike, ashtu si u deklarua edhe në takimin e mëparshëm, kryesuesja e Komisionit për Çmime të Produkteve Medicinale, nga mbledhja e kaluar e Komisionit. Por, përgjegjësia e caktimit të këtij Komisioni që i përcakton çmimet e produkteve medicinale, bazuar në metodologjinë e çmimeve referente të jashtme, është

e ministrit të MSH-së, cili duhet ta nënshkruajë më pas edhe listën që e propozon po i njëjti Komision. Por, ndodhi që e njëjta listë, më pas të anulohet pas ngritjes së shqetësimeve nga të gjitha palët e interesit dhe tash ne ende nuk kemi një listë përfundimtare, ashtu siç e kërkojnë afatet ligjore. Sa i përket konfliktit të interesit, si është e mundur që të prolongohet puna e Komisionit për Çmime të Produkteve Medicinale, kur përgjegjësia e caktimit të këtij komisioni është e vet ministrit të MSH-së, i cili është dashur para emërimit të këtij komisioni, t'iu kërkohej një CV të gjithë anëtarëve, me kërkesën që anëtarët që mund të jenë pjesë e këtij komisioni, t'i dërgojnë të dhënat edhe nga Administrata Tatimore dhe nga Trusti Pensional, dhe në këtë mënyrë, do të verifikohej shumë lehtë se në tri (3) vitet e fundit, a kanë punuar apo kanë zotëruar ndonjë kompani farmaceutikë, kjo do të ishte rruga me mirë siç e përcakton ligji për të ju shmangur konfliktit të interesit. Pyeti: Pse në përbërje të këtij komisioni nuk ka anëtar nga Oda e Farmacistëve të Kosovës, pasi ne kemi marrë ankesa se një përfaqësues i tyre është përjashtuar dhe nuk ishin të përfshirë në deri në fund të procesit final të hartimit të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale? Pse janë pranuar çmimet e deklaruara pa CIP (Çmimi CIP - është çmimi që përfshin transportin dhe sigurimin e paguar deri në vendin e destinimit), dhe si është e mundur që të ndërhyjë komisioni në formular, kur këtë gjë do të duhej ta bënte vetë operatori dhe kjo ka ndikuar që të ketë shumë gabime teknike në rritjen e çmimeve të barnat? Shembull, aspirina, që çmimin e importit e ka 1.25 euro, kurse çmimi i deklaruar sipas komisionit, del të jetë 2.94 euro, ndërsa çmimi në treg është 1.56 deri në 2 euro. Kjo ngritje e çmimit vetëm në aspirinë del të jetë gati 1 milion e gjysmë euro dhe kjo ndikon direkt në xhepin e qytetarëve dhe iu shkon për favor grupeve të caktuara të interesit. Rritja e një çmimi nga operatori farmaceutik shumë më i lartë se çmimi i importit, jep arsye për të dyshuar rreth këtij procesi në përgjithësi, sepse neni 9 i ligjit e specifikon shumë mirë përcaktimin e çmimit. Ai potencoi se duke u bazuar në këto dyshime në bazë të ligjit, ka kërkuar qasje në dokumentet zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, për listën e të gjitha produkteve medicinale për vitin 2022 dhe 2023, dhe në atë email ka qenë i përfshirë edhe ministri i MSH-së, z. Arben Vitia, por përgjigjja e AKPPM-së, është se kjo listë është konfidenciale. Por, kjo nuk është e vërtetë, sepse kjo listë është ofruar edhe më herët, pasi që kjo nuk është konfidenciale, por përgjigjja është dhënë gabimisht, duke e ngatërruar me konfidencialitetin e aplikimit për autorizim-marketing. Depoja qendrore farmaceutike e MSH-së, që ndodhet te pallati “Rilindja”, është përfshirë nga uji, për shkak të reshjeve të shiut. Cilat janë dëmet që janë shkaktuar pas vërshimit të depos dhe pse ruhen barnat në një vend ku depërton uji, kur dihen kriteret se cilat duhet të jenë kushtet për ruajtjen e barnave në një depo farmaceutike? Pse po mbahet “sekret” fundosja e depos qendrore farmaceutike e MSH-së? Si është e mundur që barnat të ruhen, në një ambient me lagështi, ku depërton uji?

**Arben Vitia, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë,** iu përgjigj pyetjeve: lidhur me depon farmaceutike, që shërben për ruajtjen e barnave, që është e përfshirë nga vërshimet, tha se nuk ka asnjë informacion lidhur me këtë çështje dhe do të interesohet, posa të informohet dhe siguroi se do ta informojë komisionin. Sa i përket ruajtjes së barnave, theksoi se ka avokuar qysh nga viti 2009, sepse asnjë depo farmaceutike nuk ka plotësuar kushtet për ruajtjen e barnave as për së afërmi, dhe lidhur me këtë, qysh nga fillimi i vitit të kaluar ka qenë në bisedime me përfaqësuesit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, për të na mundësuar transferimin në një objekt të MSH-ja, për të filluar me investime, por ka dalë një kontest gjyqësor, lidhur me një shpronësim, i cili është zgjidhur tashmë dhe tani janë në procedim të investimeve për barnatoren qendrore, e cila do t'i plotësojë të gjitha kriteret dhe kushtet e nevojshme për ruajtje të sigurt të barnave. Sa i përket vendimit që është anuluar, lidhur listën e çmimeve të produkteve medicinale, kjo ka qenë një listë

preliminare e çmimeve të barnave dhe e kam nënshkruar listën e propozuar nga Komisioni për Çmime të Produkteve Medicinale, mirëpo me kohë i kam detektuar problemet, vërejtjet se gjatë përpilimit të kësaj liste zyrtare, ka pasur gabime teknike në rritjen e çmimeve për disa produkte medicinale. Kjo gjë rregullohet edhe me afatet e përcaktuara ligjore, pas publikimit të listës, pas rekomandimeve nga Komisioni i Ankesave, ku është bërë e ditur se ka pasur ankesa prej disa kompanive farmaceutike, ku disa prej pretendimeve të këtyre kompanive janë konfirmuar edhe nga vet Komisioni i Ankesave. Ankesat kishin të bënin me çmimet në disa produkteve të barnave. Në bazë të kësaj, ka ardhur deri tek anulimi vendimit për rishikim të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale. Ky ligj po bëhet për herë të parë dhe ka si qëllim të vetëm e ka unifikimin e çmimeve të barnave dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve, lehtësimin e procesit edhe në tenderët publikë, ku çmimet kanë qenë deri më tani 40 deri 50% për qind më të larta se në vendet fqinje. Sa i përket vonësës tjetër, lidhur me konfliktin e interesit për njërin nga anëtarët e Komisionit për Çmime të Produkteve Medicinale, kjo ka ndodhur për shkak se ai ka qenë pronar i një barnatoreje dhe ka kërkuar opinion ligjor nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, se emërimi i tij në këtë komision, a ka konflikt të interesit, nga i cili ka marrë përgjigje se mund të ketë konflikt interesi dhe kjo ka prolonguar procesin, sepse në ligj është që një anëtar i komisionit nuk mund të jetë zyrtari i cili në tri (3) vitet e fundit ka punuar apo ka zotëruar kompani farmaceutike, por siç e dimë të gjithë, farmacistët punojnë diku dhe kjo pastaj ka kufizuar edhe më shumë caktimin e anëtarëve të këtij komisioni. Lidhur me përfaqësimin në Komision për Çmime të Produkteve Medicinale, të një anëtari nga Oda e Farmacistëve të Kosovës, tha se ishte një përfaqësues, por për të cilin ka pasur shumë vërejtje, lidhur me qasjen e tij, jo-bashkëpunues në proces, i cili më pas u largua. Lidhur me qasjen në dokumente publike, tha se për këtë çështje ka kontaktuar me kryeshefin e AKPPM-së dhe ai ka sqaruar se konform ligjit, kjo qasje është e kufizuar dhe listën e tillë të importit nuk e ka as vetë ai dhe kushdo që e ka ofruar këtë listë dhe ka bërë shkelje të ligjit, atëherë do të duhej të merreshin masa konform rregullores.

**Bekim Haxhiu**, sqaroi se qasjen në dokumentet zyrtare, që duhet të jetë publike, ka kërkuar sipas procedurave ligjore dhe me email zyrtar dhe kryeshefi i AKPPM-së edhe ka mundësi që e ka vu në lajthitje ministrin, sepse në përgjigjen e tij i referohet nenit të AKPPM-së për procedurën konfidenciale, për aplikim për autorizim-marketing e që është procedurë tjetër me listën e importit.

**Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë**, tha se do të konsultohet edhe me zyrën ligjore, lidhur me këtë dhe nëse përgjigjja është dhënë gabim, atëherë do të merren masat përkatëse dhe sigurisht se edhe deputetëve do t'iu ofrohet kjo listë e importit e çmimeve të produkteve medicinale.

**Bekim Haxhiu**, ritheksoi se flet me argumente dhe sipas burimeve të sakta, lidhur me temën e depos farmaceutike, që përmbytur në ujë nga vërshimet dhe për këtë çështje u bë edhe deklarimi para mediave dhe mosraportimi i saj nga zyrtarët përgjegjës, mbase edhe mund të jetë i qëllimshëm. Pyeti: Si është e mundur që prej 60 milionë eurosh, të dedikuara për listën esenciale të barnave, 20 milionë t'i përfitojë e njëjta kompani, ku po e njëjta ka qenë përfituese edhe disa kontraktimeve njëburimore nga ana e MSH-së, ku pastaj del se njëri ndër aksionarët ishte anëtar i komisionit për përpilimin e listës esenciale të barnave dhe kjo padyshim do të duhej të ishte rast për prokurorinë?

**Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë**, potencoi se procesi i blerjes së barnave është një proces që ndodh në vazhdimësi dhe kjo nuk mund të presë hyrjen në fuqi të ligjit, sepse nuk mund t'i lërë

qytetarët pa barna, por një gjë që dihet saktë, është se pasi ky ligj të hyjë në fuqi, barnat do të kenë një çmim më të lirë dhe unifikues dhe me një cilësi të garantuar të barnave, kur të shtojmë faktin se janë ndarë rreth 1 milion euro për investim në barnatoren qendrore.

**Fatmire Kollçaku**, sa i përket problemeve, lidhur me depon për ruajtjen e barnave, tha se që nga paslufta, problemi ishte i madh, sidomos kur u privatizua ndërtesa e Farmedit, si e vetmja depo që i ka plotësuar kushtet dhe më pas u promovua një objekt në Mazgit, e që ishte larg standardeve të kërkuara, duke mos hyrë në detaje edhe për skandalin e djegies së barnave. Vizitën që e realizuam në Klinikën e Onkologjisë, u informuam nga drejtuesit e kësaj klinike, se lista esenciale e barnave është plotësuar rreth 97 % për qind, prandaj përmirësimin në sektorin e shëndetësisë, qytetarët po e përjetojnë në vazhdimësi dhe kjo është për të përgëzuar punën që po bën MSH-ja dhe për këtë gjë duhet të jemi të kënaqur të gjithë.

**Armend Zemaj**, tha se për hartimi e listës zyrtare të çmimeve për produktet medicinale, është një procedurë e rëndësishme, për të cilën po diskutohet dhe është një procedurë edhe ligjore, ku është dashur të respektohen afatet ligjore të parapara me Ligjin për çmimin e produkteve medicinale. Sepse, pas publikimit të kësaj liste, kemi pasur shqetësime të ngritura në terren, dhe si rezultat i parregullsive, ka ardhur deri tek anulimi i listës dhe kërkesa për një afat shtesë, krijuan bazë për dyshime dhe nevojën për diskutim. Lidhur me prolongimin e punës së Komisionit për Çmime të Produkteve Medicinale, potencoi se ligji e sqaron shumë mirë çështjen e konfliktit të interesi, siç u cek dhe në mungesë të mospërbërjes së plotë të anëtarëve të këtij komisioni, disa prej të cilëve që janë emëruar nga ministri i tanishëm i Shëndetësisë, janë gjetur në konflikt të interesit, pasi që kanë punuar në kompanitë farmaceutikë në këto tri (3) vitet të fundit apo edhe kanë zotëruar kompani farmaceutike. Dhe pas ankesave nga palët në Komisionin e Ankesave, ka ardhur deri tek anulimi i listës zyrtare të çmimeve për produktet medicinale. Pyeti: Pse po ndodh gjithë ky prolongimi i këtij procesi, kjo çështje është e dyshimtë se pse po ndodh kjo, kur ministri i MSH-së, z. Arben Vitia, do të duhej ta shikonte dhe ta analizonte mire listën para se ta nënshkruante e jo pas nënshkrimit, ta anulonte dhe më pas të ketë ngecje në proces? Gabimet teknike në listën e barnave do të duhej të korrigjoheshin për një kohë më të shkurtër dhe të vazhdohet me zbatimin e këtij ligji kaq të rëndësishëm. Rritja e çmimeve ka ndodhur pikërisht tek ato kompani distributore, ndër vite, të lidhura me tenderët publikë dhe për këtë arsye, ndaj ministrit Arben Vitia, do të duhej të merren masa ose në të kundërtën, kryeministri duhet të kërkojë llogari prej ministrit.

**Arben Vitia, ministri i Shëndetësisë**, e potencoi se me faktin se ky ligj po bëhet për herë të parë në Kosovë dhe vështirësitë janë pritur dhe tani po bëhet përpjekje që pas gjetjes së gabimeve teknike dhe vështirësive, do të ketë mundësi për korrigjime dhe përmirësime të procesit, në mënyrë që kur të dalë lista, të ketë zbatim sa më efikas të ligjit, duke i siguruar qytetarët për shërbime më të mira të barnave dhe me çmime të unifikuara.

**Armend Zemaj**, tha se pavarësisht kërkesave nga mbledhja e kaluar e Komisionit, që ishit për përfaqësuesit e MSH-së, nuk u është dërguar ende lista e anëtarëve të komisionit për listën zyrtare të çmimeve të barnave. Mosdërgimi i emrave të anëtarëve të komisionit, është për të dyshuar. Dhe është neglizhuar procesi, lidhur me Ligjin për vendosjen e tavanit të çmimeve të barnave.

**Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë**, tha se të gjitha vendimet janë publike dhe të gjithë mund të kenë qasje në listën e emrave të anëtarëve të komisionit. Sa i përket blerjes nga lista e barnave

esenciale, potencoi se procedurat e blerjes së barnave janë në vazhdimësi, nuk mund të lihen pacientët pa barna, derisa të fillojë zbatimi i ligjit. Lidhur më çmimin CIP, që është çmimi që përfshin transportin dhe sigurimin e paguar deri në vendin e destinimit, tha se për këtë çështje është takuar me z. Hekuran Murati, ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe kanë biseduar që secili produkt medicinal, që hyn në Doganën e Kosovës, do të përcillet te MFPT-ja.

**Mirsad Shkreta**, tha se çështja e hartimit për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, ka qenë një ndër tematikat më problematike në 20 vitet e fundit dhe ka prodhuar në vazhdimësi mundësi për abuzim, ka qenë një dukuri negative e që është shfrytëzuar nga grupet e caktuara të interesit, duke shkaktuar një dëm të drejtpërdrejtë në xhepin e qytetarëve. Ka pasur në vazhdimësi tentativa për ta rregulluar këtë çështje, por që gjithmonë ka pasur ngecje. U përmendën shumë teknika rreth përbërjes së Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, por ne duhet të fokusohemi më shumë në ndikimin e këtij ligji në prokurim, te sektori publik, respektivisht te neni 14, pika 1, ku flet për efektin e Ligjit të prokurimit publik dhe te barnat e rimbursueshme, andaj na duhen më shumë informata e të cilat do të jenë të rëndësishme edhe për publikun, lidhur me atë se kur do të fillojë rimbursimi i barnave dhe cili është impakti i këtij ligji në Ligjin për sigurimet shëndetësore, si dhe kur do ta kemi të gatshëm.

**Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë**, sqaroi se rimbursimi i barnave ka impakt te Ligji për sigurimet shëndetësore dhe ky projektligj, tash i ka kaluar të gjitha fazat e diskutimeve publike. Deri në fund të muajit, do të procedohet në Qeveri.

**Shemsedin Dreshaj**, tha se është bërë një vit, qëkur ka hyrë në fuqi Ligji për çmimin e produkteve medicinale dhe ende nuk ka filluar të zbatohet, për shkak të çështjes së përbërjes së Komisionit për Çmime të Produkteve Medicinale. Në mbledhjen e kaluar, kur diskutuam për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, me zyrtarët përgjegjës të MSH-së, aty na tha se anulimi i vendimit për këtë listë, pos ankesave nga palët, është bërë edhe për shkak të disa gabimeve teknike, andaj për këtë çështje duhet të angazhohen personat profesionistë dhe ekspertët e fushës, duke përjashtuar këtu ngjyrimet politike. Pyeti për përbërjen e Komisionit për Çmime të Produkteve Medicinale, se a është në përbërje e tij plotë, e kompletuar dhe se si po funksionon, sepse kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës, në mbledhjen e kaluar të Komisionit, ka deklaruar se përfaqësuesi i OKF-së, nuk është përfshirë në përbërje të këtij komisioni? Kur pritet të miratohet lista finale për çmimin e produkteve medicinale, në mënyrë që të fillojë të zbatohet ky ligj?

**Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë**, për zbatimin e Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, tha se janë afatet e ankesave, që duhet të respektohen, prandaj kemi vonesa në zbatim, sepse është edhe për herë të parë ky ligj në zbatim. Po ashtu edhe çmimet e barnave tavan do të garantojnë çmime të unifikuara. Sa i përket emërimit të anëtarëve të Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, tha se përzgjedhjen e tyre nuk e bën mbi baza politike, por mbi bazën e vlerësimit të punës së tyre. Lidhur me deklarimin e kryetarit nga Oda e Farmacistëve të Kosovës, tha se përfaqësuesi i deleguar e ka penguar procesin e punës në komisionin për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, prandaj është kërkuar nga ta, që ta delegojnë një anëtar tjetër dhe asnjëherë nuk ka munguar bashkëpunim me ta, por është në mandatin e tyre që ta delegojnë një anëtar. Se kur pritet të miratohet lista finale për çmimin e produkteve medicinale, tha se pres pas 3 muajve, brenda këtij viti.

**Bekim Haxhiu**, sa i përket emërimit të anëtarëve të Komisionit për Çmime të Produkteve Medicinale, lidhur me anëtarin e Odës së Farmacistëve të Kosovës, se a duhet të jetë në përbërjen e këtij komisioni, tha se përfaqësimi i OMK-së, është i rregulluar edhe me Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë. Ai potencoi se me ecurinë aktuale të punës, ministri Vitia do ta përfundojë mandatin pa listë zyrtare të çmimeve të produkteve mjekësore. Sipas ligjit, brenda 6 muajve, pas miratimit të ligjit, do të duhej të publikohet lista e çmimeve, dhe sot një vit pas, nuk kemi listë zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale. Përshtypjet kanë qenë që pas miratimit të këtij ligji, do të ketë ulje të çmimit dhe jo rritje. Në bazë të analizës që kemi bërë, çmimet janë rritur shumëfish më të mëdha, sesa kanë qenë dhe të proklamosh ulje të çmimeve dhe të nënshkruash listë me rritje të çmimeve më të larta, kjo nuk ka logjikë.

**Armend Zemaj**, pyeti: Nëse janë gabime teknike, pse duhet 3 muaj më pas, prolongim të procesit? Mirë është të shikohet ndonjëherë se çka sjellin në tavolinë. Tash, ju thatë se në shtator ose vjeshtë bëhet lista finale. Pra, nëse janë gabime teknike, nëse janë evidentuar disa lëshime teknike në çmime, pse duhet 3 muaj më pas, prolongim të këtij procesi? Ne kemi dëshmuar me votë që jemi pro këtij procesi dhe kjo mungesë e informacioneve ka sjellë deri në këtë proces për të raportuar deri këtu.

**Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë**, e ritheksoi se pas nënshkrimit të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, ka kuptuar që ka gabime dhe në momentin e parë që e kemi parë, jemi ulur me komisionin dhe kemi diskutuar për ta rishikuar këtë listë. Po ashtu edhe Komisioni i Ankesave ka nxjerrë rekomandim, që të anulohet lista dhe është anuluar për ta rishikuar. Ai tha se deri në fund të vitit, do të ketë listë zyrtare të çmimeve të produkteve mjekësore, dhe me këtë listë, qytetarët do të blejnë barna me çmime më të lira. “Në tremujorin e fundit të këtij viti, besoj që qytetarët do të mund të blejnë barna me çmime të unifikuara dhe nuk do të ketë manipulime me çmimet e barnave”. Tani po flasim për një proces që nuk ka pasur një ligj që përcakton tavanin e çmimit të produkteve. Është anuluar lista, jemi duke folur për një proces që bëhet për herë të parë në Kosovë, nuk kemi pasur ligj deri më tash për rregullimin e çmimeve tavan, në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e çmimeve, prandaj ky ligj do të respektohet dhe për çdo çmim dhe problematikë jam i gatshëm të jap llogari. Është e vërtetë që ka pasur vonesa. Pas zbatimit të këtij ligji, ju siguroj që do të ketë ulje të çmimeve dukshëm. Lista do të publikohet në fund të këtij viti dhe s’do të ketë rritje çmimesh”.

**Fatmire Kollçaku**, potencoi se askush nuk ka pritur që tregu farmaceutik do të jetë i lehtë për t’u rregulluar, prandaj duhet të ketë fuqizim monitorues nga Inspektorati Farmaceutik, duke mbikëqyrur se sa po zbatohet në terren lista zyrtare e unifikimit të çmimeve për barna. Ndërsa, sa i përket përfaqësimit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, më një anëtar në Komisionin për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, kërkoi që të bisedohet me ta dhe të inkurajohen në përfshirje, në këtë proces.

## 5. Të ndryshme



**Armend Zemaj**, propozoi që gjatë muajit korrik, para se të përfundojë sesioni pranveror, të ftohet ministri i Shëndetësisë, për çështjet e përgjithshme të shëndetësisë së vendit.

**Fatmire Kollçaku**, tha se do të shohim se si po shkon rrjedha me punimet e seancave plenare dhe se si e ka agjendën ministri i Shëndetësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Fatmire Kollçaku,**

**Kryetare e Komisionit**

---